

STATUT

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

wynEnterprise sh.p.k

Neni 1

EMRI

1.1 Emri i kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar është wynEnterprise sh.p.k, këtu e më poshtë e referuar kudo në këtë Statut edhe si ("Shoqëria"). Shoqëria do të ketë vulën dhe logon e saj, të cilat së bashku me të dhëna të tjera të parashikuara në ligj, do t'i bashkëngjiten çdo dokumenti të shoqërisë drejtuar të tretëve.

Neni 2

FORMA LIGJORE

2.1 Shoqëria wynEnterprise është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar "sh.p.k".

Neni 3

THEMELIMI

3.1 Data e Themelimit të Shoqërisë është 17/06/2025. Themelues i Shoqërisë është Ortaku i Vetëm i Shoqërisë:

- Z. Masayuki Kuroda, shtetas japonez, i datëlindjes 04 tetor 1975, nr. pasaporte: TT2218310, me leje qëndrimi shqiptare nr. 286901, nr. letërnjoftimi. 839556390 dhe nr. personal. H54004004D, me adresë banimi: Rr. Beqir Luga, Nd. 3, H.1, Nj. Administrative Nr. 2, 1017, Tiranë, Shqipëri.

3.2 Shoqëria themelohet dhe do të funksionojë bazuar në Ligjin Shqiptar. Ajo do të fitojë personalitetin juridik me regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", themelohet një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "wynEnterprise" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").



Neni 4

SELIA

4.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Durana Tech Park, Rruga Ahmet Zogu, nr. pasurisë 336, ZK 3852, njësia administrative Xhafzotaj, Bashkia Shijak, kodi postar 2013, Shqipëri.

Neni 5

KOHËZGJATJA

5.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat të caktuar.

Neni 6

SHTRIRJA TERRITORIALE

6.1 Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj pa kufizim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. Ajo ka të drejtë të themelojë ose mbyllë filiale, agjensi, qendra operative, zyra përfaqësimi të çdo lloji, si dhe vende dytësore zhvillimi aktiviteti.

Neni 7

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

7.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është, përfillsh por pa u kufizuar në, zhvillimin e të gjithë llojeve të produkteve softuer për tregun vendas dhe ndërkombëtar. Këto do të jenë produkte të vecanta për inxhinier softuer të cilët zhvillojnë softuer për palë të treta/kliente si dhe për përdorues përfundimtar, qofshin këto: Produkte të softuerike si dhe projekte softuer me zgjidhje në lidhje me produktet dhe shërbimet e teknologjisë no-code dhe low-code. Shoqëria do të zhvillojë produkte me fokus Inteligjencën e Biznesit në përgatitje e raporteve të lehta për t'u përdorur me vizualizime që nuk kërkojnë aftësi teknike për përdoruesit fundorë, përshtatje të përmbajtjes për rajone të ndryshme përmes përkthimit dhe formatimit, analizim të dhenash në nivel organizativ për vendimmarrje strategjike për përmirësim të Inteligjencës në Biznes. Shoqëria do të shërbejë me zgjidhje të inteligjencës në biznes që veteintegrohen brenda çdo strukture, të cilat gjenerojnë analiza dhe raporte në çdo hollësi të punës, dhe kanë format licensimi të shkallëzueshëm. Shoqëria synon të kryej aktivitete kërkimore dhe zhvillimore në inovacion në algoritme dhe modele nëpër industri të ndryshme, përfillsh por pa u kufizuar edhe në Inteligjencën Artificiale. Shoqëria do të zhvillojë të gjitha llojet e Shërbimeve Softuer të Gjuheve të huaja dhe të Programeve të gjuhës Angleze. Shërbimet Softuer të Gjuheve do të ofrohen në marrëdhëniet ndërmjet bizneseve si dhe direkt të Operatorëve të Konsumatorëve, përfillsh por pa u kufizuar në GrapeSEED. Zhvillimin e shërbimeve Softuer të sipërmendura që

perfshijne morfologjine, testimin dhe progresin e arritur nga mesuesit dhe studentet, si dhe licensimin e tij per GrapeSEED dhe operatore te tjere. Shoqeria do te veproje gjithashtu si rishites per GrapeSEED dhe shoqeri te tjera ne vendet e perzgjedhura per te cilat ka nje Marreveshje.

7.2 Kompania do të zhvillojë të gjitha llojet e shërbimeve softuer në formate të shumta mediatike. Ofrimi i shërbimeve softuer për ofruesit e programeve Business-to-Business dhe Direct-to-Consumer.

Neni 8

VLERA E KAPITALIT TË NËNSHKRUAR TË SHOQËRISË

8.1 Kapitali i nënshkruar i Shoqërisë ka një vlerë totale prej 100,000 LEK (njëqind mijë).

8.2 Ortaku i Vetëm i Shoqërisë është Z.Masayuki Kuroda. E gjithë vlera e kapitalit të nënshkruar të Shoqërisë do të shlyhet nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, brenda një periudhe tremujore nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

8.3 Kapitali i nënshkruar i shoqërisë ndahet gjithësej në një (1) kuotë e cila zotërohet nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë.

8.4 Vlera e kontributit të nënshkruar të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë, në Kapitalin e nënshkruar të Shoqërisë është gjithësej 100,000 LEK (njëqind mijë).

8.5 Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, në bazë të vlerës së kontributit që nënshkruan në kapitalin e shoqërisë, sipas përcaktimeve mësipër në Klauzolën (8.4), do të zotërojë një kuotë me vlerë nominale sipas sa vijon:

- a) Ortaku i Vetëm, Z. Masayuki Kuroda, zotëron një (1) kuotë, me vlerë nominale gjithësej 100,000 LEK (njëqind mijë), e cila përfaqëson 100% të vlerës së kapitalit të regjistruar/nënshkruar të Shoqërisë.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve.

Neni 9

SHLYERJA E KONTRIBUTIT NGA ORTAKU

9.1 Ortaku Themelues detyrohet të shlyejnë kontributin e tij të nënshkruar në kapitalin e regjistruar/nënshkruar të shoqërisë, sipas vlerës së përcaktuara në klauzolën (8.4), të këtij Statuti dhe nëpërmjet dhënies së kontributit në para.



9.2 Ortaku Themelues detyrohet të bëjë shlyerjen e kontributit të nënshkruar brenda një periudhe tre mujore, nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

9.3 Ekzekutimi i pagimit të referuar mesipër nga Ortaku Themelues duhet të bëhet nëpërmjet derdhjes së shumës në llogarinë bankare të shoqërisë, dhe sipas përcaktimeve në Klauzolën (8.4), të këtij Statuti.

Neni 10

TRANSFERIMI

10.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Neni 11

SHPËRNDARJA E FITIMEVE

11.1 Ortaku i Vetëm ka të drejtën që të vendosë për shpërndarjen e çdo fitimi të shoqërisë, që rezuftojnë sipas pasqyrave financiare të shoqërisë, me kusht që të zbatohet të gjitha rregullat dhe kufizimet e parashikuara në Ligjin Nr.9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar.

Neni 12

ORTAKU I VETËM

12.1 Meqënëse kapitali i regjistruar i Shoqërisë zotërohet nga një Ortak i Vetëm, ky i fundit do të ushtrojë të gjithë të drejtat dhe detyrimet e parashikuara për Asamblenë e Përgjithshme në dispozitat e zbatueshme të Ligjit Nr.9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar.

12.2 Ortaku i Vetëm i Shoqërisë është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emërimin e shkarkimin e administratorëve;



- d) Emërimin e shkarkimin i likujduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) Përcaktimin e shpërblimeve për Administratorët, Likujduesve dhe Ekspertëve Kontabël të Autorizuar;
- f) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë;
- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë së veprimtarisë, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës;
- h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë në rast të procedimeve ndaj administratorëve;
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) Miratimin e rregullave procedurale në lidhje me funksionimin e organeve të shoqërisë;
- m) Çdo çështje tjetër që është kompetencë e tij sipas ligjit ose statutit.

12.3 Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm regjistrohen në një Regjistër të Vendimeve, sipas rregullit kronologjik.

Neni 13

ADMINISTRATORI

13.1 Ortaku i Vetëm emëron një individ si Administrator të Shoqërisë.

13.2 Administratori i Shoqërisë emërohet për një kohëzgjatje prej pesë (5) vjet, dhe është i rizgjedhshëm.

13.3 Administratori i Shoqërisë ka të drejtë dhe detyrohet të:

- a) Kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Ortaku i Vetëm;
- b) Të bëjë përfaqësimin ligjor të shoqërisë, në të gjitha marrëdhëniet ndërmjet shoqërisë dhe të tretëve, dhe sipas kufizimeve të vendosura kohë pas kohe nga Statuti dhe Ligji. Administratori me Prokurë të Posaçme mund të delegojë në çdo kohë tek persona të tjerë të përzgjedhur prej tij, një pjesë të të drejtave të tij, që i njihen sipas ligjit dhe statutit.
- c) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të gjithë dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) Përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecuresë së veprimtarisë, dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara Ortakut të Vetëm për miratim;
- e) Krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për evidentimin në kohë të rrethanave që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë. Kur evidenton rrethana të tilla informon menjëherë Ortakun e Vetëm;



- f) Në mënyrë të vazhdueshme, kryen të gjitha regjistrimet dhe dërgon të gjitha të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) Raporton përpara Ortakut të Vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) Kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligji dhe statuti.

13.4 Administratori i Shoqërisë duhet të zbatojë të gjitha kufizimet e tagrave të tij të përfaqësimit, të përcaktuara në Ligjin Ligjit Nr.9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar, dhe ato të përcaktuara kurdoherë në statutin e shoqërisë.

13.5 Ortaku i Vetëm mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë dhe për çfarëdolloj shkak.

13.6 Administrator i Shoqërisë për periudhën e parë pesëvjeçare, emërohet:

• Z. Angjelos Shkurti, shtetas shqiptar, i datëlindjes 02 tetor 1993, nr. pasaporte: BR3171262 dhe nr. personal. J31002086N, me adrese banimi: Rr. Petro Nini Luarasi, Nd. 5, H.13, Ap. 43, Nj. Administrative Nr. 2, 1010, Tiranë, Shqipëri.

Neni 14 PËRFAQËSIMI

Administratori ka të drejtën e përfaqësimit të shoqërisë kundrejt të tretëve dhe në gjykim. Ai mund të caktojë avokatë dhe përfaqësues të shoqërisë përpara organëve gjyqësore, organeve të administratës shtetërore dhe të tretëve, si dhe përfaqësues të posaçëm për akte të veçanta ose kategori aktesh.

E drejta e firmës së shoqërisë mund të ushtrohet edhe nga personat të cilëve u është deleguar kjo e drejtë brenda kufijve të kompetencave të dhëna. Administratori ka të drejtën e rimbursimit të shpenzimeve të bëra gjatë ushtrimit të funksioneve si dhe një shpërblim vjetor të përcaktuar nga asambleja e ortakëve në momentin e emërimit ose me vendim të posaçëm.

Neni 15 VITI USHTRIMOR DHE BILANCI

Viti ushtrimor mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti.

Në mbyllje të çdo viti ushtrimor, organi administrativ harton bilancin e vitit ushtrimor, brenda afateve dhe në përputhje me dispozitat e ligjit. Bilanci mund t'u paraqitet ortakëve për miratim brenda njëqindetëdhjetëditëve nga mbyllja e vitit ushtrimor. Dokumentat e kontabilitetit, të shoqëruara nëse e nevojshme nga relacioni i ekspertëve kontabël të autorizuar, duhet t'u komunikohen ortakëve dhe të vihen në dispozicion të tyre pranë selisë së shoqërisë, të paktën 15 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë.



Neni 16
FINANCIMI I ORTAKËVE

Shoqëria mund të marrë nga ortakët financime me ose pa shpërblim, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Dhënia e këtyre financimeve nga ana e ortakëve është e lirë.

Neni 17
PRISHJA DHE LIKUJDIMI

14.1 Prishja e Shoqërisë bëhet për rastet e parashikuara nga ligji dhe kurdoherë kur konsiderohet e arsyeshme nga Ortaku i Vetëm.

14.2 Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë ka si pasojë hapjen e procedurave të likujdimit në gjendjen e aftësisë pagueuse, në përputhje me dispozitat ligjore të zbatueshme.

14.3 Likujdimi kryhet nga likujduesit e emëruar nga Ortaku i Vetëm. Miratimi i Likujduesit është kompetencë e Ortakut të Vetëm, me përjashtim të rasteve kur shoqëria tregtare priset me vendim gjykate dhe emërimi i Likujduesit është kompetencë e kësaj të fundit. Nëse Ortaku i Vetëm nuk merr një vendim për emërimin e likujduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likujdues.

14.4 Likujduesi në kryerjen e veprimtarisë së vet i nënshtrohet mbikëqyrjes së Ortakut të Vetëm.

Neni 18
LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

Gjithçka nuk është parashikuar shprehimisht në këtë statut do të disiplinohet nga dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 19
DISPOZITA FINALE

Ky statut u hartua në 3 (tre) kopje të njëjta në gjuhën Shqipe.
Lexuar, pranuar dhe nënshkruar nga Ortaku themelues i shoqërisë.

ORTAKU THEMELUES

Ortaku i Vetëm

Z. Masayuki Kuroda: MASAYUKI KURODA 